



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 461/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhore, vendosjes së posterit më afër se 100m nga Qendra e Votimit (QV), në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, nga subjekti politik PDK dega në Prizren, në të cilën theksohet se një grup simpantizantesh prej 7 deri 10 persona nga LDK-ja, kanë hyrë në Qendrën e Votimit (QV) me numër 2065/a në fshatin Medvec komuna e Prizrenit me maica me mbishkrimin e LDK, me këtë rast kanë prishur qetësinë publike, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 4.1 pika k) të rregullorës 11/13 dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre thuhet në pretendimet e ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet e tilla ankimore të subjektit politik PDK-së kanë mungesë të provave, për tu bindur se ka parregullsi si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindese për parregullsitë e për këto arsye duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i paqartë andaj në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 461/2013 më datën 06.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*